



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	05-10-2023	3	viti god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtup. e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SH/18/2023	6406/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1070/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1070/2023 të datës 09.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes përfaqësuesit me autorizim avokat [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër Vendimit 2837 të datës 10.07.2023 të te udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 2837 të datës 10.07.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. **OBLIGOHET** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e lëndës të parashtruar nga ankuesi [redacted]

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] punësuar në Ministrinë e Punëve Jashtme dhe Diasporës, duke e pare se nuk është duke iu llogaritur sakte përvoja e tij e punës, përmes emailit zyrtar disa here ka parashtruar kërkesa për njohjen e përvojës së punës tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore konkretisht me datën 01.03.2023, 24.04.2023, 25.04.2023 dhe me 27.04.2023. Ndërsa ky i fundit me datën 10.07.2023 ka marr Vendimin me Nr.Ref.204/2023 përmes te cilit ankuesit i është njohur përvoja e punës prej njëzet (20) vite e dhjete (10) muaj.



Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me Nr.Ref204/2023 të datës 10.07.2023, përmes përfaqësuesit me autorizim avokat [REDACTED] ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se vendimi i atakuar është përcjell me konstatim të gabuar të gjendjes faktike, zbatim i gabuar dhe arbitrar të legjislacionit në fuqi si dhe shkelje e të drejtave kushtetuese të parashtruesit të ankuesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 23.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 22.09.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 559/2023 të datës 09.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vërtetimin me numër 2068-1 të datës 26.05.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vërtetimin me numër 222 të datës 27.04.2023 të lëshuar nga Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovës; Njoftimi i datës 30.10.2012 mbi shuarjen; Deklaratën në Betim të ankuesit; Pasqyra e Llogarisë-Trustin, për periudhën kohore 01.08.2002 deri me 25.07.2023; Emalin e datës 05.10.2028 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 05.10.2018 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 05.10.2018 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 05.10.2018 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 27.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 25.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 25.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 25.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 25.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 24.04.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 01.03.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 01.03.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.08.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1070/2023 të datës 18.09.2023; Akt emërimin e datës 05.09.2012; Vendimin për sistemim me numër Ref. 224/2022 të datës 01.09.2022; Vërtetimin e datës 30.01.2023; Certifikatën pa date dhe numër me të cilën dëshmohet përvoja e punës së ankuesit për periudhën 01.10.2004 deri me 05.02.2008; Emalin e datës 17.08.2023 të [REDACTED] drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 17.08.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 03.10.2023 të [REDACTED] drejtuar KPMSHCK-së; Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera; Vendimi me numër protokollit 6196/2023 i datës 22.09.2023 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; emalin e datës 03.10.2023 të [REDACTED] drejtuar KPMSHCK-së; Gjendja e përgjithshme e transaksioneve të tjera e datës 03.10.2023;



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet ne *rishqyrtim*, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rezulton se ankuesi sipas Vendimit te datës 01.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm te MPJD-së e ushtron pozitën e punës se „Udhëheqësit të Qendrës për Menaxhimin e Krizave“, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. I njëjti duke e pare se nuk është duke iu llogaritur sakte përvoja e tij e punës, përmes emalit zyrtar disa here ka parashtruar kërkesa për njohjen e përvojës se punës tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore konkretisht me datën 01.03.2023, 24.04.2023, 25.04.2023 dhe me 27.04.2023. Ndërsa ky i fundit me datën 10.07.2023 ka marr Vendimin me Nr.Ref.204/2023 përmes të cilit ankuesit i është njohur përvoja e punës prej njëzet (20) vite e dhjete (10) muaj.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se vendimi me Nr.Ref204/2023 i datës 10.07.2023, është përcjell me konstatim të gabuar të gjendjes faktike, zbatim i gabuar dhe arbitrar të legjislacionit në fuqi si dhe shkelje e të drejtave kushtetuese të parashtruesit të ankuesit sepse ankuesit përmes vendimit në fjalë i janë njohur vetëm njëzet (20) vite e dhjetë (10) muaj përvojë pune duke mos i njohur përvojën e punës për periudhën kur ankuesi ka qenë pronar i biznesit të tij privat D.P.T „Beni Keramike“, të cilën e dëshmon me dokumentin-vërtetimin zyrtar të lëshuar nga një institucion publik i Republikës së Kosovës gjegjësisht nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) që është ne kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i'u referua nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën e Punës për të Punësuarit në Sektorin Publik, Neni 6 Llogaritja dhe dëshmimi i përvojës së punës 1. *Përvoja e punës llogaritet mbi pagën bazë, në masën: 1.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind, (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 1.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë.* 2. *Përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon: 2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989, 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (M1,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-certifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zejtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim. 2.2. pas qershorit 1999: 2.2.1. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; 2.2.2. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike*





ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim; 2.2.3. dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin; 2.2.4. dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent; 2.2.5. dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar; 2.2.6. çdo dëshmie tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm; 2.2.7. dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave. 3. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë rregullore, vendosë për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili merr pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin i punësuar dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi. 4. Të punësuarit aktual në sektorin publik të cilët e kanë të evidentuar përvojën e punës, nuk i nënshtrohen zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, gjate administrimit te provave te lendes ka gjetur se ankuesi me rastin e parashtrimit të kërkesës për njohjen e përvojës së punës ka dorëzuar këto dëshmi; Vërtetimin me numër 138/2023/2 të datës 26.05.2023 me të cilën vërtetohet se ankuesi nga data 22.12.2008 është në marrëdhënie pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vërtetimin e datës 27.04.2023 të lëshuar nga ARBK-ja; Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën 20.04.2005 deri me datën 30.06.2023; Vërtetimin e datës 30.01.2023 me të cilën vërtetohet se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në MPMS nga data 09.09.2002 deri me 01.10.2004; Certifikatën e lëshuar nga Shefi i Divizionit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me përvojën e punës nga data 01.10.2004 deri me datën 05.02.2008;

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin me numër Ref.204/2023 të datës 10.07.2023 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, sepse ankuesi në emalin e datës 27.04.2023 drejtuar Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me qëllim të njohës se përvojës së punës ka bashkangjitur Vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) si dëshmi se që nga data 27.04.2001 ka qenë pronar i biznesit të tij privat D.P.T „Beni Keramike”, andaj ky i fundit, ka qenë i obliguar që sipas detyrës zyrtare të shqyrtoj dhe të kërkoj dëshmi shtesë lidhur me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës së ankuesit në këtë institucion respektivisht ky obligim rrjedh sipas nenit 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”.

Andaj, duke qenë se vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj kërkesën e ankuesit, nëse është e nevojshme të kërkoj prova tjera shtesë nga ankuesi respektivisht të kërkoj dëshmi për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent gjegjësisht nga Administrata Tatimore e Kosovës, në mënyrë që të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja lidhur me përvojën e punës së ankuesit dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.





Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda më numër A.nr.1070/2023


Ilire MEHMETI-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

  
Malsore GASHI-BAJRAKTARI  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokat 
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

